



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ÇËRRIK

Data: 26.01.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ *Blerje materiale per sherbimet publike dhe sherbimet e brendshme te bashkise Cerrik*”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Produkte boje 30192110-5, Materiale ndërtimi dhe produkte të ngjashme 44100000-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

10000000 (dhjete milion) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Cerrik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave

te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të vendosura në Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të vënë në dispozicion.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore në një vlerë, sa vlera e përlloritur e fondit limit të marrëveshjes kuadër që prokurohet, dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2019, 2020, 2021) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar., ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

2.2.3 Vertetimi për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, sipas përcaktimeve të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet, nga secili anëtar i bashkimit.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Operatori ekonomikë fitues duhet të paraqesë përpara njoftimit të fituesit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar), si dhe faktit që në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 20% të fondit limit pa TVSH-, të realizuara (nga subjekti juaj) në tri vitet e fundit financiar nga data shpalljes së njoftimit të kontratës..

Për këtë rast të paraqiten vërtetimet të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesi një dëshmi nga administrata tatimore për punesimin mesatar jo më pak se 10 punonjës për te paktën muajin e fundit shoqëruar me Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe vertetimin për pagesën e kontributeve. **Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Operatori ekonomike fitues duhet të paraqese përpara njoftit mit te fituesit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar.**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 40 “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 5 dhe 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion

apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

2.3.3 Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë në stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit punonjesit si me poshte te cilet duhet te figurojne ne listepagesa te pakten per muajin e fundit:

1 Teknikë të proceseve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. – listepagesa e muajit te fundit ku punonjesi te jete i perfshire (do te vezhgohet nga KVO kodi perkates i regjistrimit ne listepagese)+ diplome

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik1” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Në nenin 40 “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 5 dhe 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

1 Teknikë të proceseve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit është I nevojshem për shkak se në preventivin fillestar përcaktohen zerat si : **12 UPS UPS 800 VA / 450 WATTS**

13 *bateri Bateri ups 12AH*

14 *Mirembajtje paisje zyre Sherbim riparimi dhe mirembajtje të 80 kompjuterave, paisje fotokopje, printer skaner, instalime programesh instalime softuer, konfigurimi I rjetit të internetit, vleresim I gjendjes së paisjeve teknologjike etj.*

15 *Mirembajtje teknologjise kaldajave në shkollë e kopshte 7 Kaldaja me pelet dhe Karburant, vleresim I gjendjes së paisjeve teknologjike, riparim I difekteve që lidhen me teknologjinë e paisjes. të cilët e kanë të nevojshme praninë e një tekniku të teknologjisë dhe informacionit .*

Eshtë i nevojshem një teknik i teknologjisë së informacionit për shkak të shërbimeve të cilat do të kryhen si shërbim dhe riparim i kompjuterave, instalime software, konfigurim rrjeti interneti, defekte që lidhen me pjesën teknologjike të kaldajave të shkollave etj.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të pakten mjetet dhe makinerite e mëposhtme:

Kamion me vinc	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Kamioncine (apv) deri 1.5 ton	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera

a) Dokumentacion që vërteton pronësinë ose marrjen me qera:

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / Kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit / Çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

Kontratë qiraje.

Në cdo rast të shoqeruara me:

1. Leje qarkullimi e mjetit;
2. Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore;
3. Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve;
4. Fotot perkatëse;

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit ose faturat e shitjes të shoqeruara me dokumentacion pronesie të shitesit (zhdoganim apo kontrata blerjeje) si dhe fotot, ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave të cilat duhet të jete për të gjithë periudhën e realizimit deri në perfundimin e plote të punimeve.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Operatori ekonomike fitues duhet të paraqesë përpara njoftit të fituesit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Jane te nevojshme dy mjetet per shkak se do te kryhet trasporti i mallrave objekt prokurimi ne magazinën e Autoritetit kontraktor.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur edhe me çertifikatat e meposhtme të lidhura me objektin qe kërkohet të prokurohet:

- Sistemi manaxhimit te cilesise ISO 9001 (e vlefshme) Qëllimi i certifikimit të operatorit ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet
- Sistemi menaxhimit te mjedisit ISO 14001:2004 – Qëllimi i certifikimit të operatorit ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet
- Sistemi menaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune ISO 45001 (e vlefshme) Qëllimi i certifikimit të operatorit ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 te VKM-914 date 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoj sipas aktmarrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në piken 1 te nenit 44 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.Ky kriter kerkohet per te patur garancine se malli qe do te dorezohet do te jete brenda standarteve te kerkuara.

- Sistemi menaxhimit te mjedisit ISO 14001:2004 – Qëllimi i certifikimit të operatorit ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në piken 1 te nenit 44 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.

- Sistemi menaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune ISO 45001 (e vlefshme) Qëllimi i certifikimit të operatorit ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në piken 1 te nenit 44 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 te VKM-914 date 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoj sipas aktmarrëveshjes.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së mallrave/ materialeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së materialeve që kërkohet të kryhet furnizimi i tyre, njësia e prokurimit ka kërkuar çertifikatën e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto materiale (ka të bëjë me parimet e produkteve, duke filluar nga faza e projektimit, prodhimit dhe shitjes së produktit/ materilialit) duke i dhënë besimin e qëndrueshmërisë së produkteve/ materialeve blerësit (Autoritetit Kontraktor)

2.3.7 Deklarate per dorezimin e mallit te kerkuar nga autoriteti ne sasine dhe vendodhjen e kerkuar. Operatori ekonomik merr persiper qe me shpenzimet e tij te beje transportin e mallit nga fabrika ne vendndodhjen e kerkuar nga autoriteti kontraktor, si dhe plotesimin e kriterëve te tjera perkatesisht sipas përcaktimeve ne preventiv e specifikime teknike

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të dorezojnë mallrat me shpenzimet e tij.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostrat e kërkuara si me poshte:

Nr.	Emertimi	Sasia
1	Ndricues Rrugor 50w	Cope 1
2	Sensor Muzgu + automat 63A+ Leshues 3 fazor 63A + kuti metalike	Cope 1
3	Krahe tek per ndricim	Cope 1
4	UPS	Cope 1
5	bateri	Cope 1
6	Boje plastike e pergatitur	Liter 1
7	Boje plastike	Liter 1
8	Moket	Cope 1
9	Kufizues shpejtesie	Cope 1
10	Bojë për vijëzim asfalti/ betoni (e bardhë)	Liter 1
11	Bojë për vijëzim asfalti/ betoni, (e verdhë)	Liter 1
12	Bojë për vijëzim asfalti/ betoni, (e kuqe)	Liter 1
13	Set për lyerje , mbajtese bojë mini rulon + teflon	Cope 1
14	Rrula 21 cm	Cope 1
15	Pllaka shtrimi	Cope 1
16	Prize shuko universale	Cope 1

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6,a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.6.Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) **mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose,,**

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar ne zbatim te nenit 36 te ligjit nr.162/2020 “ Per prokurimin Publik” dhe nenit 78 pika 2 e VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

Specifikimet janë hartuar nga specialistet e fushes dhe gjenden bashkengjitur dokumentave standarte te tenderit.

Njesia e Prokurimit
